



Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë

Përfaqësuesi i Lirisë së Medias

STATUTI

I

RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR

(Miratuar nga Kuvendi më 1 qershor 2000)

Nga

Karol Jakubowicz, Ph.D.

Drejtor, Departamenti i Strategjisë dhe Analizës

Këshilli Kombëtar i Transmetimit të Polonisë

Zëvendëskryetar, Komiteti Drejtues i Masm medias

Këshilli i Evropës

Gusht 2004

PARATHËNIE

Ky rishikim, i porositur nga Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias, ka për qëllim të përcaktojë nëse Statuti i Radiotelevizionit Shqiptar, si një transmetues publik, është në përputhje me standartet evropiane.

Me “standarte evropiane”, do të kemi parasysh kryesisht standartet e përcaktuara nga vetë OSBE-ja¹, ashtu si edhe ato të vendosura nga Këshilli i Evropës në dokumentet e tij të ndryshëm për transmetimin publik.

Duke pasur parasysh negociatat e Shqipërisë për pranimin e saj në të ardhmen në Bashkimin Evropian, do të kemi parasysh, gjithashtu, edhe kriteret e BE-së. Kjo do të lidhet kryesisht me pajtueshmërinë e transmetimit publik në Shqipëri me rregullat në fuqi në Bashkimin Evropian për ndihmën që jep shteti.

HYRJE

Miratimi i Statutit të Radiotelevizionit Shqiptar nga Këshilli i tij Drejtues kërkohet nga Neni 99 i Ligjit 8410 për Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat në Republikën e Shqipërisë. Ky nen përshkruan, gjithashtu, në terma të përgjithshëm përmbajtjet e këtij dokumenti si më poshtë:

Në statutin e RTSH-së, përcaktohet:

- a) struktura e institucionit;*
- b) organet drejtuese dhe kompetencat e tyre;*
- c) kriteret dhe procedurat për zgjedhjen dhe shkarkimin nga puna të Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm, drejtorëve të radios dhe televizionit, ashtu si dhe shefave të departamenteve;*
- d) përshkrimin e punës të të gjitha kategorive të punonjësve;*
- e) përshkrimin e veprimtarisë financiare dhe ekonomike të RTSH-së.*

Sipas Nenit 143 të ligjit, Këshilli Drejtues ia paraqet Statutin Kuvendin për miratim.

Neni 1 i vetë Statutit shprehet se objekti i tij është “rregullimi i përgjithshëm dhe në hollësi i veprimtarisë së këtij institucioni kombëtar” dhe se ai synon “të caktojë rregulla të mjaftueshme, që mundësojnë procesin e kalimit nga radiotelevizion shtetëror në radiotelevizion publik dhe të garantojë funksionimin normal të RTSH-së”.

Ky objektivi i fundit i Statutit është i një rëndësie të veçantë dhe do të sigurojë një kuadër reference për analizimin e këtij dokumenti.

¹ Shih i.a. Liria e Shprehjes, Rrjedha e Lirë e Informacionit, Liria e Medias. KSBE/OSBE Dispozitat kryesore 1975-1999. Vjenë: Përfaqësuesi për Lirinë e Medias, Korrik 2000; Angazhimet e OSBE-së për Dimensionin Njerëzor, Udhëzues. Varshavë: ODIHR, 2001

Një raport drejtuar Këshillit të KSBE-së mbi Seminarin e organizuar nga KSBE-ja me Ekspertë të Institucioneve Demokratike, zhvilluar në Oslo (nëntor 1991), thotë se “një sistem i larmishëm dhe i pavarur shtypi dhe transmetimi ka një rol shumë të rëndësishëm në çdo demokraci”. Kjo është edhe më e vërtetë për transmetimin publik. Bashkimi Evropian ka thënë qartë në Protokollin e Amsterdimit të vitit 1997 se sistemi i transmetimit publik në Shtetet Anëtare është drejtpërsëdrejti i lidhur me nevojat demokratike, sociale dhe kulturore të secilës shoqëri dhe me nevojën për të ruajtur pluralizmin e medias (shih gjithashtu edhe dokumentet e zgjedhura mbi detyrën e transmetimit publik në Shtojcë).

Rekomandimet e miratuara nga një konferencë me temë “Transmetimi Publik: Sfida të reja, Zgjidhje të Reja”, organizuar nga OSBE-ja në bashkëpunim me Institutin Evropian për Median dhe RTV-në Slloveni (Ljubjanë, 11 mars 2003), vënë në dukje se “është e nevojshme të përcaktohet një sistem transmetimi që siguron garanci programore dhe strukturore, të cilat mbulojnë informacion të pavarur dhe një përfaqësim të të gjitha grupeve të shoqërisë, ashtu sikurse dhe ofrojnë një platformë integrimi për të gjithë. Një sistem i tillë është në gjendje t’i japë formë identitetit kombëtar, pjesëmarrjes përmes kulturës dhe edukimit, dhe, së fundi, novacioneve në transmetim si një vlerë kulturore. Këto funksione nuk mund të garantohen të gjitha nga një sistem tregtar. Ato mbulohen në mënyrë tipike nga sisteme të transmetimit publik”.

Sipas Rekomandimeve, transmetuesit publikë duhet të jenë të aftë të ruajnë një nivel të lartë të prodhimit të programeve origjinale, me qëllim që të përmbushin detyrimet dhe vendosin një standard programimi të një cilësie të lartë për industrinë e transmetimit në tërësi. Ndërkohë që ruajnë dallimin e tyre të qartë nga transmetuesit tregtarë, ata duhet të jenë të aftë për të tërhequr një audiencë të gjerë. Është, gjithashtu, roli i tyre që të kryesojnë novacionin teknologjik, me qëllim që të përdorin teknologji të reja dhe gjithë platformat e përshtatshme të shpërndarjes për të arritur audiencën.

Më tej, dokumenti kërkon që parlamentet dhe qeveritë në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore të miratojnë ose të përmirësojnë kuadrin ekzistues ligjor dhe institucional që transmetimi publik të mund të arrijë këto qëllime. Ky kuadër duhet të mbrojë pavarësinë dhe përgjegjshmërinë publike të organizmave të transmetimit publik, *inter alia*, duke e ndarë atë nga shërbimi civil dhe duke hequr çdo ndërhyrje të pajustificuar nga autoritetet publike në funksionimin e tyre, si dhe të sigurojë financimin e tyre të mjaftueshëm dhe të sigurtë. Dispozitat ligjore duhet të përcaktojnë detyrën e transmetuesit publik në mënyrë të qartë, të detajuar dhe të verifikueshme, duke i ndarë ato qartë nga transmetimi komercial, por, në të njëjtën kohë, duke lënë vend për programe tërheqëse për një masë të gjerë në axhendën e tyre. Kjo ofertë programi duhet t’i shërbejë të gjitha grupeve të shoqërisë, përfshirë edhe ato që neglizhohen nga transmetuesit tregtarë, si pakicat etnike e të tjerë. Shtetet duhet të nxisin dhe të promovojnë skema vetërregulluese në fushën e standarteve të programeve dhe etikës së gazetarit. Ato duhet, gjithashtu, të mbrojnë edhe ekzistencën e arkivave audiovizive brenda organizmave të transmetimit publik si trashëgimi audiovizive e një kombi për t’u përdorur nga transmetuesit publikë për përfitime të përgjithshme.

Së fundi, sipas dokumentit, sistemet e financimit për transmetimin publik duhet të garantojnë burime të ndryshme të ardhurash (duke përfshirë tarifatat e licencimit, reklamat, subvencionet e qeverisë dhe të ardhurat e veta), ashtu si dhe transparencë financiare të transmetuesve publikë, duke përfshirë llogaritë të ndara për veprimtaritë programuese dhe ato jopublike, në qoftë se ekzistojnë. Nëse reklamat lejohen, ato duhet të trajtohen vetëm si burime suplementare të ardhurash. Aty ku sigurohen subvencione nga qeveria, ato duhet të jepen mbi baza të sigurta dhe afatgjata, pa cënuar pavarësinë e transmetuesve publikë. Duhet të krijohen skema të veçanta financiare ose asistencë, me qëllim që transmetuesit publikë të jenë në gjendje të fusin teknologjinë numerike dhe të zhvillojnë kanale të reja për transmetim numerik tokësor.

Pikërisht në kontekstin e këtyre parimeve do të analizohet edhe Statuti i RTSH-së.

I. VLERËSIM I PËRGJITHSHËM I STATUTIT

Statuti është një dokument i detajuar, i cili përkufizon me saktësi shumë aspekte të strukturës, organizimit, sistemit të administrimit dhe funksionimit të RTSH-së. Kjo është siç duhet, por fakti se Statuti duhet të miratohet nga Kuvendi dhe se mund të ndryshohet vetëm me pëlqimin e tij do të thotë se Kuvendi ka kontroll mbi çdo aspekt të organizimit dhe veprimtarive të transmetuesit publik.

Statuti mbulon të gjitha fushat e renditura në listën e nenit 99 të ligjit 8410, megjithëse sistemi i administrimit financiar, në të vërtetë, nuk mbulohet plotësisht.

Neni 1 i vetë Statutit thotë se ai synon “të caktojë rregulla të mjaftueshme, që mundësojnë procesin e kalimit nga radiotelevizion shtetëror në radiotelevizion publik dhe të garantojë funksionimin normal të RTSH-së”. Në fakt, ai jep shumë pak vlera të tjera në krahasim me ligjin 8410 përse i përket procesit të kalimit nga transmetim shtetëror në atë publik. Ai, kryesisht, përsërit dispozita statutoare, ose e drejton lexuesin tek këto dispozita, duke iu ofruar pak ndihme administratorëve dhe punonjësve të RTSH-së dhe publikut të gjerë për të kuptuar më mirë se çfarë do të thotë të jesh transmetues publik dhe se si duhet kryer detyra e shërbimit publik. Në shumë aspekte, Statuti duket si një dokument që ka lidhje me një transmetues tradicional shtetëror.

Cdo rishikim i mëvonshëm i Statutit duhet të përqendrohet në fushat e mëposhtme:

- Nevojën për përshtatje të plotë të ligjit me standartet evropiane për lirinë e shprehjes dhe transmetimin publik;
- Përkufizim të qartë të statusit të RTSH-së si një institucion publik, që gëzon liri editoriale dhe autonomi institucionale;
- Nevojën për një përkufizim më të plotë dhe më të qartë të detyrimeve të programeve të RTSH-së;

- Ndryshimet në sistemin e administrimit dhe të menaxhimit financiar që mundësojnë një funksionim më të efektshëm, mundësi për të llogaritur dhe ulur kostot, si dhe për të rritur leverdinë.

II. KOMENTE TË HOLLËSISHME MBI STATUTIN

Detyra e RTSH-së

Detyra

Kjo është trajtuar në nenin 2 dhe përsëri në nenet 39 dhe 40, në çdo rast, bazuar në nenet përkatëse të Ligjit 8410 për Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat në Republikën e Shqipërisë.

Si i tillë, Statuti nuk jep ndonjë vlerë më shumë në këtë fushë, krahasuar me vetë Ligjin. Ndërsa, në terma shumë të përgjithshme, detyra përcaktohet saktë, nga ana tjetër mungojnë shumë elementë. Kjo lidhet në veçanti me parimin se, ndërsa ruajnë dallimin e tyre nga transmetuesit tregtarë, transmetuesit publikë duhet të jenë në gjendje të tërheqin një audiencë të gjerë. Gjithashtu, është roli i tyre t'i prijnë novacioneve teknologjike, me qëllim që të përdorin teknologji të reja dhe të gjitha platformat e përshtatshme të shpërndarjes për arritjen e audiencës.

Siç u vu në dukje më sipër, dispozitat ligjore duhet të përkufizojnë detyrën e transmetimit publik në një mënyrë të qartë, të hollësishme dhe të verifikueshme. Kjo është e rëndësishme sidomos përse i përket rregullave të Bashkimit Evropian të Ndhmës së Shtetit, siç është bërë e qartë në Mesazhin nga Komisioni mbi zbatimin e rregullave të Ndhmës së Shtetit dhënë transmetimit publik (2001/C 320/04).

Ky mesazh thotë se një përkufizim “i gjerë”, që i ngarkon një transmetuesi të caktuar detyrën e sigurimit të programeve të ekuilibruara dhe të larmishme në përputhje me detyrën e tij, ndërkohë që ruan një nivel të caktuar audience, mund të konsiderohet, i ligjshëm sipas Nenit 86(2), duke pasur parasysh dispozitat interpretuese të Protokollit. Një përkufizim i tillë do të ishte në përputhje me objektivin e plotësimit të nevojave demokratike, sociale dhe kulturore të një shoqërie të veçantë dhe të garatimit të pluralizmit, duke përfshirë shumëllojshmërinë kulturore dhe linguistike”. Megjithatë, në kontekstin e kalimit nga një transmetues shtetëror në një transmetues publik, një përkufizim i qartë dhe i kontrollueshëm i detyrës do të lehtësonte procesin e kalimit dhe do ta mbronte RTSH-në nga cënimi i pavarësisë së saj.

Këto ndryshime duhet të përfshihen në Statut, në mënyrë që RTSH-ja të ketë një përkufizim më të plotë dhe më të qartë të detyrimeve të saj programore. Gjithsesi, varet shumë nga fakti nëse ndonjë rishikim në të ardhmen i Ligjit 8410 për Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat në Republikën e Shqipërisë do ta heqë kushtin për miratimin nga Kuvendi të Statutit, siç rekomandohet më poshtë. Nëse jo, atëherë Statuti do të ruajë statusin e tij si një dokument zyrtar, që ia ngarkon shërbimin publik RTSH-së, dhe që shërben si një plotësues formal i Ligjit.

Nëse do të jetë kështu, atëherë, ndryshimet e sugjeruara më sipër duhet të bëhen edhe në Ligj, pasi ai do të jetë dokumenti i vetëm zyrtar që do të përkufizojë detyrën e RTSH-së.

Programet

Neni 39 i Statutit jep një listë të plotë të programeve që duhet të transmetojë RTSH-ja. Kjo mënyrë përjasjeje është korrekte, meqenëse detyrimet e një transmetuesi programesh duhet të përkufizohen shumë qartë. Megjithatë, kjo është një listë e mbyllur, që nuk lë mundësi për ndryshime apo shtesa programesh të reja, nëse krijohen mundësi për këtë.

Prandaj, do të ishte e këshillueshme që ky nen të plotësohej me dispozita që përshkruajnë procedurat e brendshme, sipas të cilave mund të merret një vendim për të rritur (ose zvogëluar) numrin e programeve të transmetuara nga RTSH-ja, dhe se kujt duhet t'i drejtohet një kërkesë për miratim të një veprimi të tillë (do të preferohej Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit).

Gjithashtu, në Statut nuk përmendet përdorimi i teknologjive të reja nga RTSH-ja. Megjithatë, siç u vu në dukje më sipër, është roli i transmetuesit publik të paraprijë novacionet teknologjike, me qëllim përdorimn e teknologjive të reja dhe të gjitha platformave të përshtatshme të shpërndarjes për arritjen e audiencës.

Rekomandimi Rec (2003) 9 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Masat për të Promovuar Kontributin Demokratik dhe Social të Transmetimit Numerik i kërkon shteteve anëtare të “krijojnë kushte financiare, teknike dhe të tjera të nevojshme që i duhen transmetuesve publikë për të përmbushur detyrat e tyre sa më mirë, ndërkohë që i përshtaten mjedisit të ri numerik”. Më tej, ky rekomandim thotë se “mjetet për të përmbushur detyrën e shërbimit publik mund të përfshijnë sigurimin e kanaleve të reja të specializuara, për shembull, në fushën e informacionit, edukimit dhe kulturës, dhe të shërbimeve të reja ndërvepruese, për shembull, EPG-të dhe shërbime *on-line* programesh. Transmetuesit publikë duhet të luajnë një rol qendror në procesin e kalimit në transmetim numerik tokësor”.

Kjo duhet të korrigohet në një rishikim të mëvonshëm të ligjit, në mënyrë që dera të jetë e hapur për RTSH-në për të përdorur teknologji të reja, kurdo që të lindë nevoja dhe mundësia.

Prodhimi i programeve

Sipas nenit 44, RTSH-ja duhet të jetë “prodhuesi kryesor i programeve të veta të Radios dhe Televizionit”. Megjithatë, ajo mund të kalojë, shkallë-shkallë, në bashkëprodhime vetëm programesh edukative, kulturore, artistike dhe argëtuese me prodhues privatë, vendas dhe të huaj. Në të ardhmen, “ajo mund të porosisë programe të prodhuara nga të tretë”.

Kjo dispozitë duket të jetë projektuar për të mbrojtur interesat e punonjësve të RTSH-së, ose monopolin e tyre mbi prodhimin e programeve për RTSH-në. Kufizimi i bashkëprodhimeve vetëm në “programe edukative, kulturore, artistike dhe argëtuese” duket se vjen nga supozimi se zhanret e programeve të tjera, përfshi këtu lajmet, çështjet aktuale, dokumentarët dhe programet faktike, duhet të prodhohen së brendshmi.

Porositja e prodhimeve nga prodhuesit e pavarur (“të tretët”) shihet si diçka që mund të ndodhë në të ardhmen e papërcaktuar.

Këto dispozita nuk janë të justifikueshme. Do të duhet të futet një kuotë e prodhimeve të pavarura prej të paktën 10% të kohës së transmetimit (pa llogaritur kohën e caktuar për lloje të caktuara programesh) në procesin e harmonizimit të legjislacionit shqiptar të transmetimit me rregulloren e BE-së. Në parim, nuk ka arsye pse një transmetues publik nuk mund të bashkëprodhojë apo të porosisë [programe] nga një prodhues i pavarur - çdo lloj zhanri programesh, duke përfshirë edhe lajmet (megjithëse kjo ndodh rrallë) apo çështjet aktuale (që është shumë më e zakonshme). Mundësia për të tërhequr ide, talent dhe kapacitete prodhimi të jashtëm do t'i japë programuesve të RTSH-së më shumë liri zgjedhjeje dhe një tërësi më të pasur talentesh dhe idesh programesh mbi të cilat mund të mbështetet. Ky qëndrim duhet të rishikohet.

Pakicat

Sipas nenit 20 të Kushtetutës së Shqipërisë, të drejtat e pakicave duhet të respektohen plotësisht, dhe personat që i përkasin pakicave kombëtare kanë të drejtë të shprehin lirshëm, pa u ndaluar apo detyruar, përkatësinë e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore.

Edhe BE-ja e vlerëson gatishmërinë e vendeve candidate për t'u bashkuar në bazë të kriterëve të Kopenhagenit, duke përfshirë kriteret politike, ku “anëtarësimi kërkon që vendi kandidat të sigurojë qëndrueshmëri të institucioneve që garantojnë demokraci, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe respektimin dhe mbrojtjen e pakicave”.

Në këtë kontekst, është inkurajuese të vëmë në dukje se, sipas nenit 2 të Statutit, RTSH-ja “realizon shërbime cilësore radioje dhe televizioni për të informuar, edukuar dhe argëtuar publikun, duke i shërbyer kombit, të gjitha grupeve të shoqërisë, përfshi këtu edhe pakicat kombëtare”. Neni 40 shprehet për “respektimin e dinjitetit dhe të të drejtave themelore të njeriut, paanshmërinë dhe objektivitetin e informacionit, te drejtat e fëmijëve, gjuhën dhe kulturën shqiptare, të drejtat kushtetuese të shtetasve dhe pakicat kombëtare”.

Megjithatë, Statuti jep shumë pak informacion se çfarë bëhet në praktikë për të mbrojtur ushtrimin e të drejtave të pakicave. Normalisht, pritjet të shihen dispozita për sasinë e kohës së transmetimit që u jepen, si minimum, në shërbimet kombëtare dhe rajonale për programet në gjuhët e pakicave, se cilave pakica duhet t'iu shërbejë një stacion rajonal, etj.

Sipas një studimi të porositur dhe publikuar nga OSBE-ja², disa stacione radioje publike rajonale, degë të RTSH-së, transmetojnë programe të destinuara në mënyrë specifike për pakicat kombëtare. Kështu, në vitin 2003, *Radio Gjirokastra*, me vendndodhje në jug të Shqipërisë, transmetonte 45 minuta lajme të përditshme dhe program argëtues në gjuhën greke; *Radio Tirana*, me vendndodhje në Shqipërinë e mesme, transmetonte një program në gjuhën greke për 30 minuta çdo ditë; *Radio Korça*, me vendndodhje në jug-lindje të Shqipërisë, transmetonte një buletin lajmesh prej 40 minutash në gjuhën maqedonase tre herë në javë. Thuhet se RTSH-ja ka instaluar edhe një përsëritës në Malin e Dajtit për sinjalin e stacionit publik grek, ERT, për shikuesit në Tiranë.

Ky është një informacion që mirëpritet, por mungesa e dispozitave formale do të thotë se asgjë nuk do të mund të parandalonte ndalimin ose zvogëlimin e një veprimtarie të tillë.

Statuti dhe Pavarësia e RTSH-së

Forma ligjore dhe statusi i RTSH-së nuk janë përkufizuar në asnjë lloj mënyre, përveç se [RTSH-ja] është përshkruar si person juridik (neni 3 i Statutit) dhe “institucion” në nenin 64 të Ligjit dhe “institucion kombëtar” në nenin 1 të Statutit.

Sipas nenit 51 të Statutit, “E gjithë pasuria e luajtshme dhe e paluajtshme, që, në çastin e hyrjes në fuqi të Ligjit 8410, datë 30.09.1998, “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë”, ka qenë në përdorim të RTSH-së, është në pronësi të saj”.

Siç u vu në dukje më sipër, kuadri ligjor lidhur me transmetimin publik duhet të mbrojtë pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e tij publike, *inter alia*, duke e ndarë atë nga shërbimi civil dhe duke hequr çdo ndërhyrje të pajustificuar nga autoritetet publike në funksionimin e tyre. **Në këtë kontekst, fakti se as Ligji, as Statuti nuk e përkufizojnë RTSH-në si një transmetues të pavarur publik, dhe nuk e mbrojnë pavarësinë e tij, përbën një pakujdesi dhe dobësi serioze të kuadrit ligjor.**

Në Rekomandimin e tij Nr. R (96) 10 mbi Garancinë e Pavarësisë së Transmetimit Publik, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës rekomandoi që shtetet anëtare “të përfshijnë në ligjin e tyre vendas ose në instrumentet që rregullojnë dispozitat e organizatave të transmetimit publik që garantojnë pavarësinë e tyre”. Shtojca e këtij Rekomandimi përcakton parimet e mëposhtme:

Kuadri ligjor që rregullon organizmat e transmetimit publik duhet të përcaktojë qartë pavarësinë e tyre editoriale dhe autonominë institucionale, sidomos në fusha si:

² Tarlach McGonagle, Bethany Davis Noll, Monroe Price (eds) Transmetimi në Gjuhën e Pakicave dhe Legjislacioni në OSBE. Studimi i porositur nga Komisioneri i Lartë i OSBE-së për Pakicat Kombëtare, prill 2003.

- përkufizimin e planeve të programeve;
- konceptimin dhe prodhimin e programeve;
- redaktimin dhe prezantimin e programeve të lajmeve dhe çështjeve aktuale;
- organizimin e veprimtarive të shërbimit;
- marrjen në punë dhe administrimin e stafit brenda shërbimit;
- blerjen, marrjen me qera, shitjen dhe përdorimin e mallrave dhe shërbimeve;
- administrimin e burimeve financiare;
- përgatitjen dhe zbatimin e buxhetit;
- negociimin, përgatitjen dhe firmosjen e akteve ligjore, që kanë lidhje me funksionimin e shërbimit;
- përfaqësimin e shërbimit në proceset ligjore dhe në lidhje me të tretë.

Sipas raporteve të Task Forcës së Paktit të Stabilitetit për Median për Evropën Jug-Lindore, RTSH-ja, nga ana formale, ka një pavarësi editoriale, por, “nga publiku, shihet si shumë e ndikuar nga qeveria”. Nuk është e qartë nëse ky ndikim është formal apo joformal, apo të dyja bashkë. Do të duhej më shumë informacion për të përcaktuar si është situata nga një këndvështrim ligjor dhe praktik .

Sidoqoftë, fakti që Kuvendi emëron Këshillin Drejtues të RTSH-së, me një shumicë anëtarësh të zgjedhur nga vetë Kuvendi, dhe se ai miraton Statutin e RTSH-së, është një tregues i kufizimeve formale të rrepta të pavarësisë së RTSH-së. Ne do të japim më poshtë komente mbi përbërjen dhe mënyrën e emërimit të Këshillit Drejtues. Duhet vënë në dukje se miratimi nga Kuvendi i një Statuti shumë të hollësishëm (me rregulla të hollësishme që kanë lidhje me strukturën dhe mënyrën e funksionimit të këtij organizmi dhe me përshkrime pune për shumicën e pozicioneve të larta administrative), ashtu si dhe kushti që çdo ndryshim në Statut duhet të miratohet edhe nga Kuvendi, janë kufizime të qarta të autonomisë institucionale të RTSH-së në shumë fusha, por sidomos në organizimin e veprimtarive të shërbimit; menaxhimin e stafit brenda shërbimit; dhe përgatitjes dhe nënshkrimit të akteve ligjore që kanë lidhje me funksionimin e shërbimit.

Këto kushte lënë të kuptosh se, praktikisht, në funksionimin e RTSH-së nuk mund të bëhet asnjë ndryshim pa pëlqimin e Kuvendit. Kjo mund të pengojë në një masë të konsiderueshme mundësinë e RTSH-së për të vepruar në një treg konkurrues, ku aftësia për t’iu përshtatur rethanave që ndryshojnë me shumë shpejtësi është një domosdoshmëri.

Kushti për miratim nga Kuvendi të Statutit të RTSH-së (shih nenin 61 të Statutit) duhet të hiqet. Është Këshilli Drejtues, në rolin e tij si përfaqësues i shoqërisë i ngarkuar me mbikëqyrjen e RTSH-së, që duhet të miratojë dhe ndryshojë Statutin. Projekt-Statuti mund të përgatitet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili, gjithashtu, duhet të ketë mundësinë t’i propozojë Këshillit Drejtues ndryshime në Statut. Kjo do t’i jepte RTSH-së kontroll mbi organizimin dhe mënyrën e funksionimit, si dhe përshtatshmërinë që duhet për të paraqitur ndryshime kur të jetë e nevojshme.

Organet Drejtuese të RTSH-së

Neni 8 përsërit dispozitën e Ligjit 8410 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë”, se organet administruese të RTSH-së janë:

- a) Këshilli Drejtues
- b) Drejtori i Përgjithshëm
- c) Bordi i Administrimit.

Përbërja dhe mënyra e emërimit të Këshillit Drejtues përcaktohen në Ligj. Një situatë në të cilën shumica e anëtarëve të Këshillit janë të emëruar politikë nuk mund t'i shërbejë RTSH-së dhe as pavarësisë së tij. Ligji duhet të ndryshohet në mënyrë të tillë që pushteti për të zgjedhur gjithë kandidatët për anëtarë të Këshillit t'i vishet shoqërisë civile që ka lidhje me këtë, organizatave joqeveritare dhe profesionale, në mënyrë që Kuvendi të emëronte individë që me të vërtet përfaqësojnë interesat e shoqërisë në përgjithësi, dhe jo vetëm interesat e politikanëve.

Ndërkohë që ndarja e kompetencave dhe detyrave midis Këshillit Drejtues dhe Drejtorit të Përgjithshëm përfaqëson një model klasik dhe të përhapur gjerësisht në shumë organizma të transmetimit publik, **nevoja për Bordin e Administrimit nuk është e qartë.**

Bordi i Administrimit të RTSH-së, emëruar nga Këshilli Drejtues, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, përshkruhet në nenin 18 të Statutit si “një organ këshillimor i Drejtorit të Përgjithshëm, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 113 të Ligjit nr.8410, datë 30 shtator 1998, ”Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë” për çështjet e administrimit dhe për çështjet financiare e të biznesit të RTSH-së”. Sipas këtij neni, miratimi i Bordit Administrativ nevojitet për veprimtaritë e mëposhtme:

- Kontratat e punësimit, përfundimin e marrëveshjeve dhe negociatave për konfliktet me sindikatat;
- Blerjen, shitjen dhe lënien peng të pasurisë;
- Marrjen dhe shlyerjen e kredive bankare;
- Përfundimin e kontratave për investimet e reja, kur shumat për t'u investuar nga RTSH-ja është mbi 5-10 për qind e buxhetit vjetor të institucionit.

Është e vështirë të pritët që anëtarët e Bordit – që janë plotësisht të varur nga Drejtori i Përgjithshëm – të veprojnë në mënyrë të pavarur në këto raste dhe të mund të kundërshtojnë Drejtorin e Përgjithshëm.

Sipas nenit 19 të Statutit, Bordi i Administrimit harton projektbuxhetin vjetor të RTSH-së; harton bilancin financiar vjetor me të dhënat e paraqitura nga Drejtoria Ekonomiko-financiare, brenda afateve të përcaktuara në ligj; jep mendim për shpenzimet e paparashikuara në buxhet; i paraqet Drejtorit të Përgjithshëm raportin për shpenzimet dhe të ardhurat e RTSH-së, në formë raportesh financiare, mujore, tremujore dhe gjashtëmujore, pasi ka marrë të dhënat e nevojshme nga departamentet dhe sektorët e RTSH-së; shqyrton kontratat shumta e të cilave kalon 5 për qind të buxhetit vjetor të RTSH-së.

Të gjitha këto detyra mund të ndërmerren njëloj nga stafi i RTSH-së, pa qenë nevoja për një organ të veçantë (këshillimi) administrimi. Vendimet që tani kërkojnë “pëlqimin” e Bordit të Administrimit duhet të rezervohen për Këshillin Drejtues, meqenëse ato përfaqësojnë saktësisht llojin e vendimeve që duhet të merren nga organi që mbikëqyr gjithë organizimin.

Struktura e RTSH-së

Siç rregullohet nga neni 6 i Statutit, struktura organizative e RTSH-së është si më poshtë:

- a) Drejtoria e Përgjithshme e RTSH-së.
- b) Drejtoria e Televizionit Shqiptar.
- c) Drejtoria e Radio Tiranës.
- ç) Drejtoria e Stacioneve Transmetuese të RTV-së.
- d) Qendrat rajonale të radios dhe televizionit
- dh) Drejtoria Ekonomiko-financiare.
- d) Drejtoria e Aktualitetit

Sigurisht që përsa i përket strukturës së brendshme dhe organizimit të një transmetuesi publik, nuk ka standarde evropiane. Siç u theksua edhe në Protokollin e BE-së në Amsterdam për Sistemin e Transmetimit Publik në Shtetet Anëtare, i përket secilit Shtet Anëtar të “japë, përkufizojë dhe organizojë” detyrën e shërbimit publik në transmetim. Sidoqoftë, kjo strukturë përfaqëson një mënyrë mjaft tipike dhe tradicionale të organizimit të një transmetuesi, megjithëse sigurisht që mund të gjenden edhe zgjidhje të tjera strukturore.

Drejtuesit që menaxhojnë secilën prej këtyre njësive organizative emërohen nga Këshilli Drejtues me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, i cili propozon më shumë se një kandidat për secilin post (shih nenin 14 të Statutit).

Arsyet për shkarkimin e mundshëm të Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm, Drejtorit të TVSH-së, Drejtorit të RT-së dhe shefave të departamenteve, përcaktohen në nenin 15:

- a) kur provohet se ai është pengesë në zbatimin e detyrimeve që ngarkon Ligji nr.8410, datë 30.09.1998, “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë”;
- b) kur aplikon praktika të reformës institucionale dhe praktika punësimi të pambështetura në ligj dhe në aktet e tjera që rregullon marrëdhëniet e punës;
- c) kur personat e sipërpërmendur, në mënyrë të përsëritur, thyejnë ose nuk zbatojnë vendimet dhe rregulloret e miratuara nga Këshilli Drejtues;
- ç) kur me veprimet ose mosveprimet e tyre sjellin dëme të konsiderueshme financiare dhe programore në veprimtarinë e RTSH-së.

Arsyet për shkarkim të përcaktuara në pikat a) dhe b) janë shumë të përgjithshme dhe të paqarta dhe mund t’i hapin rrugë veprimeve arbitrare. Kjo duhet të rishikohet.

Financimi dhe Administrimi Financiar

Sistemi i Financimit

Nenet 54 dhe 55 të Statutit dhe nenet 115-118 të Ligjit përmbajnë një listë të gjatë të burimeve reale dhe të mundshme³ financimi për RTSH-në, duke përfshirë:

- Tarfifat e transmetimit të mbledhura nga publiku;
- Financimin nga buxheti i shtetit, si për qëllime specifike (shërbime radioje për shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë; shërbime radioje për publikun e huaj (në gjuhë të huaja); shërbime televizive për shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë; orkestra simfonike e RTSH-së dhe kinematografisë) dhe për projekte të veçanta (projekte të rëndësishme teknike për futjen e teknologjive të reja në prodhim dhe transmetim; projekte të rëndësishme prodhimi filmik ose veprimtari artistike të mëdha mbarëkombëtare). Përveç këtyre, ministritë dhe institucione të tjera shtetërore “financojnë projekte të veçanta me rëndësi kombëtare në fushat e kulturës, të shkencës dhe të edukimit, me miratimin e Këshillit Drejtues të RTSH-së” (neni 118 i Ligjit);
- Veprimtari tregtare të ndërmarra nga vetë RTSH-ja, duke përfshirë reklamat dhe sponsorizimet.

Procedura dhe rregullat për përcaktimin e nivelit të tarifës së transmetimit nuk përcaktohet në Statut apo në Ligj. Megjithatë, meqënëse ajo përshkruhet në ligj si një taksë “e pagueshme për radio individuale dhe aparate televizioni në përputhje me legjislacionin fiskal në Republikën e Shqipërisë”, duhet të nënkuptohet se niveli i tarifës përcaktohet nga qeveria. Gjithashtu, buxheti i shtetit siguron fonde, si për qëllime të veçanta, ashtu dhe rast pas rasti për “projekte të veçanta me rëndësi kombëtare”. Neni 55 thotë se masa e financimit nga ky burim “përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit të shtetit, kështu që, teorikisht, çdo masë (si shumë e madhe apo shumë e vogël) është e mundur.

Ky sistem financimi është një shkak për t’u shqetësuar për një sërë arsyesh:

- Ai nuk është në përputhje me parimet e përcaktuara në Rekomandimet e miratuara nga konferenca me temë “Transmetimi Publik: Sfida të Reja, Zgjidhje të Reja”, organizuar në bashkëpunim me OSBE-në, dhe në Rekomandimin Nr. R (96) 10 për Garancinë e Pavarësisë së Transmetimit Publik, miratuar nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës;
- Ka shumë gjasa që ai të mos jetë në përputhje me kërkesat e BE-së përsa i përket ndihmës së Shtetit, siç shpjegohet në Mesazhin nga Komisioni për aplikimin e rregullave të ndihmës së Shtetit dhënë transmetimit publik (2001/C 320/04).

Rekomandimet kërkojnë financim të mjaftueshëm dhe të sigurtë të transmetuesve publikë. Edhe Rekomandimi i Këshillit të Evropës thotë se “rregullat që rregullojnë financimin e organizmave të transmetimit publik duhet të bazohen në parimin se shtetet

³ Për shembull, neni 54 përmend “shërbimet audiovizuale me pagesë për publikun” si një burim të ardhurash. Ky është ndoshta një burim më tepër potencial financimi sesa një burim real.

anëtare marrin përsipër të ruajnë dhe, ku është e nevojshme, të vendosin një kuadër financimi të përshtatshëm, të sigurtë dhe transparent, i cili u garanton organizmave të transmetimit publik mjetet e nevojshme për të kryer misionet e tyre”.

Situata ku niveli i tarifës së transmetimit vendoset, me sa duket, pa përfshirjen e RTSH-së dhe ku ministritë apo institucionet e tjera mund ose nuk mund të japin para shtesë, do të thotë se financimi nuk është i sigurtë dhe se nuk ka garanci se ai do të sigurojë “mjetet e nevojshme për kryerjen e misioneve [të RTSH-së]”. Sipas rregullave të BE-së, është po aq e rëndësishme që, të paktën, në teori, nuk ka garanci se RTSH-ja nuk mund të marrë shumë më tepër para sesa kërkon kryerja e misionit të tij publik (shih më poshtë).

Më tej, Rekomandimi i Këshillit të Evropës thotë:

Në rastet kur financimi i transmetimit publik bazohet tërësisht ose pjesërisht në një kontribut të rregullt ose të veçantë nga buxheti i shtetit, ose në tarifën e licencimit, duhet të aplikohen parimet e mëposhtme:

- *pushteti vendimmarrës i autoriteteve jashtë organizmit të transmetimit publik në fjalë përse i përket financimit të tij, nuk duhet të përdoret për të ushtruar, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, ndonjë ndikim mbi pavarësinë editoriale dhe autonominë institucionale të këtij organizmi [të transmetuesit publik];*
- *niveli i kontributit apo tarifës së licencës duhet të përcaktohet pas konsultimeve me organizmin e transmetuesit publik të interesuar, duke marrë parasysh tendencat në kostot e veprimtarive të tij dhe në një mënyrë që e lejon këtë organizëm të përmbushë plotësisht misionet e tij të ndryshme;*
- *pagesa e kontributit ose tarifës së licencimit duhet të bëhet në një mënyrë që garanton vazhdimësinë e veprimtarive të organizmit të transmetimit publik dhe që e lejon atë të angazhohet në planifikim afatgjatë;*

Sistemi i financimit të RTSH-së nuk duket se është në përputhje me ndonjë nga këto parime:

- **Pushteti vendimmarrës i autoriteteve jashtë organizmit të transmetimit publik, si përse i përket nivelit të tarifës së transmetimit dhe akordimit (ose jo) të fondeve shtesë për projekte të veçanta mund të përdoret për të ushtruar presion mbi RTSH-në;**
- **As niveli i kontributit nga buxheti i shtetit, as niveli i tarifës së transmetimit nuk duket se përcaktohen pas konsultimeve me RTSH-në (megjithëse për financimin e projekteve të veçanta kërkohet miratimi i Këshillit Drejtues);**
- **Një sistem i tillë financimi nuk ofron garanci për aftësinë e RTSH-së për t’u angazhuar në planifikime afatgjata.**

Përse i përket kërkesave të BE-së, i gjithë ky sistem do të duhet të përshtatet me kërkesat e BE-së përse i përket ndihmës së Shtetit, siç përcaktohet në nenin 87(1) të Traktatit, Protokollit të Amsterdimit dhe Mesazhit nga Komisioni për aplikimin e rregullave për ndihmën e dhënë nga Shteti transmetimit publik (2001/C 320/04).

Shtetet Anëtare të BE-së janë të lira të zgjedhin mjetet e financimit të transmetimit publik, por kjo nuk mund të ndikojë tek konkurrenca në tregun e përbashkët në një mënyrë të shpërpjesëtuar. Kjo do të thotë se niveli i financimit publik (tarifa e transmetimit, subvencionet dhe grantet e Shtetit, etj) nuk mund ta kalojnë nivelin e nevojshëm për kryerjen e misioni të shërbimit publik. Gjithashtu, RTSH-ja do të duhet të përfshijë llogari të veçanta: (a) llogaritë e brendshme që i korrespondojnë veprimtarive të ndryshme, d.m.th. veprimtarive publike dhe jopublike do të duhet të jenë të ndara; (b) të gjitha kostot dhe të ardhurat duhet të caktohen ose shpërndahen mbi bazën e parimeve të llogaritjes së kostos të justifikueshme objektivisht dhe që aplikohen në vazhdimësi; dhe (c) duhet të vendosen qartë parimet e llogaritjes së kostos, sipas të cilave llogaritë mbahen të ndara.

RTSH-ja do të duhet ta bëjë këtë dhe të përfshijë rregulla për tregtinë e ndershme, me qëllim që të parandalojë çdo subvencionim të tërthortë të veprimtarive tregtare nga financimi publik.

Menaxhimi Financiar

Sipas nenit 5, “RTSH-ja e kryen veprimtarinë e vet mbështetur në drejtimin ekonomik-financiar të decentralizuar”.

Kjo thënie duket se kundërshtohet nga neni 32, i cili përshkruan kompetencat e Drejtorit të Financave së RTSH-së. Sipas këtij neni, Drejtori i Financave, midis të tjerash:

1. përgatit në bashkëpunim me drejtoritë e programeve radiotelevizive, sektorët teknikë e ato të prodhimit, buxhetet e specifikuar vjetore të çdo njësie organizative të RTSH-së, buxhetin vjetor të RTSH-së dhe ia paraqet për veprim të mëtejshëm Drejtorit të Përgjithshëm dhe Bordit të Administrimit;
2. përgatit në bashkëpunim me drejtoritë e programeve radiotelevizive, sektorët teknikë dhe të prodhimit bilancet vjetore të çdo njësie të veçantë organizative dhe bashkë me të dhënat për bilancin vjetor të RTSH-së, ia paraqet për veprim të mëtejshëm Drejtorit të Përgjithshëm dhe Bordit të Administrimit;
3. mbikëqyr dhe kontrollon realizimin e buxheteve të çdo njësie organizative të RTSH-së, nëse janë përdorur në përputhje me vendimet e marra dhe i propozon me shkrim Drejtorit të Përgjithshëm dhe Bordit të Administrimit masat përkatëse;
4. nxjerr kostot e prodhimit, të shërbimeve e shpenzimeve, i përpunon ato dhe ia paraqet ato me shkrim Drejtorit të Përgjithshëm dhe Bordit të Administrimit;
5. në bashkëpunim me Drejtorin e Burimeve Teknike e të Zhvillimit, harton projekte tarifash për prodhimet radiotelevizive e shërbimet për të tretë dhe ua paraqet ato organeve vendimmarrëse të RTSH-së.

Kjo krijon përshtypjen e një sistemi shumë të centralizuar administrimi financiar. Kjo përshtypje forcohet nga dispozita e nenit 54 që thotë se “tarifat për shërbime [tregtare] [të kryera nga lehtësitë dhe burimet teknike të RTSH-së] miratohen me votim të

hapur, me shumicën e dy të tretave të votave nga Bordi i Administrimit dhe Këshilli Drejtues.

E gjithë kjo mund të kuptohet se, megjithëse si Ligji, ashtu edhe Statuti krijojnë përshtypjen se RTSH-ja është një organizatë e orientuar drejt komercialitetit dhe tregut (me shumë mundësi për t'u angazhuar në veprimtari tregtare për të fituar të ardhura shtesë), financat e saj në fakt janë nën një kontroll qendror të rreptë në nivelin më të lartë (në Këshillin Drejtues, kërkohet një shumicë prej dy të tretave të votave për të miratuar tarifat për shërbime tregtare, po aq sa edhe për emërimin dhe shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm!). Prandaj, potenciali tregtar dhe ekonomik i RTSH-së nuk mund të përdoret plotësisht. Gjithashtu, ky sistem nuk mund të sjell leverdi në funksionimin e RTSH-së, apo kontrollimin dhe uljen e kostove.

Nëse është kështu, ky sistem nuk mund t'i shërbejë mirë RTSH-së.

SHTOJCË

DOKUMENTE TË ZGJEDHURA MBI DETYRËN E TRANSMETIMIT PUBLIK

Konferenca e 4^{rt} Ministrove Evropiane mbi Politikën e Mas-Medias (Pragë, 7-8 dhjetor 1994)

Rezolutë Nr.1: E ardhmja e Transmetimit Publik

Kërkesat për shërbimin publik

Shtetet pjesëmarrëse bien dakort që transmetuesit publikë, brenda kuadrit të përgjithshëm të përcaktuar për ta dhe pa paragjykime për detyrat më specifike të shërbimeve publike, duhet të kenë parimisht misionet e mëposhtme:

- të ofrojnë, nëpërmjet programeve të tyre, një pikë reference për gjithë anëtarët e publikut dhe një faktor për kohezionin social dhe integrimin e gjithë individëve, grupeve dhe komuniteteve. Në veçanti, ato duhet të hedh poshtë çdo diskriminim kulturor, seksual, fetar dhe racor, si dhe çdo formë të veçimit social;
- të ofrojnë një forum për diskutime publike, në të cilin mund të shprehet një spektër sa më i gjerë pikëpamjesh dhe mendimesh që të jetë e mundur;
- të transmetojnë lajme, informacione dhe komente të paanshme dhe të pavarura;
- të zhvillojnë programe pluraliste, të reja dhe të larmishme, të cilat plotësojnë standartet e etikës dhe cilësisë së lartë dhe jo të sakrifikojnë arritjen e cilësisë për hir të forcave të tregut (kërkes ofertës);
- të zhvillojnë dhe strukturojnë programe dhe shërbime në interes të publikut të gjerë, duke qenë të vëmendshëm ndaj nevojave të grupeve të pakicave;

- të pasqyrojnë idetë e ndryshme filozofike dhe besimet fetare në shoqëri me synimin e forcimit të mirëkuptimit reciprok dhe tolerancës, si dhe promovimit të marrëdhënieve në komunitet në shoqëri shumëetnike dhe shumëkulturore;
- të kontribuojnë në mënyrë aktive përmes programeve të tyre për një vlerësim dhe shpërndarje më të madhe të shumëllojshmërisë së trashëgimisë kulturore kombëtare dhe evropiane;
- të garantojnë që programet e ofruara përmbajnë një pjesë të konsiderueshme programesh origjinale, sidomos filma me metrazh të gjatë, drama dhe vepra të tjera krijuese, si dhe të kenë parasysh nevojën për të përdorur prodhues të pavarur dhe për të bashkëpunuar me sektorin e kinemasë;
- të zgjerojnë mundësinë e zgjedhjes për shikuesit dhe dëgjuesit duke ofruar edhe programe që, normalisht, nuk ofrohen nga transmetuesit tregtarë.

Rekomandimi Rec (2003) 9 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës drejtuar Shteteve Anëtare për Masat që duhen marrë për të Promovuar Kontributin Demokratik dhe Social të Transmetimit Numerik

2.2. Parime që duhet të zbatohen në transmetimin publik

a. Detyra e transmetimit publik

19. Në përballje me sfidat që lidhen me arritjen e teknologjive numerike, transmetimi publik duhet të ruajë detyrën e tij të veçantë sociale, duke përfshirë një shërbim të përgjithshëm bazë që ofron lajme, programe edukative, kulturore dhe argëtuese që synojnë kategori të ndryshme të publikut. Shtetet anëtare duhet të krijojnë kushtet financiare, teknike dhe të tjera që duhen për të mundësuar transmetuesin publik të përmbushë detyrën e tij sa më mirë, ndërkohë që përshtatet me mjedisin e ri numerik. Në këtë drejtim, mjetet për të përmbushur detyrën e shërbimit publik mund të përfshijnë sigurimin e kanaleve të reja të specializuara, për shembull, në fushën e informacionit, edukimit dhe kulturës dhe shërbimeve të reja ndërvepruese, për shembull, EPG-të dhe shërbime *on-line* programesh. Transmetuesit publikë duhet të luajnë një rol qendror në procesin e kalimit në transmetimin numerik tokësor.

b. E drejta universale për transmetimin publik

20. Universaliteti është themelor për zhvillimin e transmetimit publik në epokën numerike. Prandaj, shtetet anëtare duhet të sigurohen se janë krijuar kushtet ligjore, ekonomike dhe teknike për t'i dhënë mundësi transmetuesit publik që të jetë i pranishëm në platformat e ndryshme numerike (kabllor, satelitor, tokësor) me programe cilësore të larmishme dhe shërbime që janë në gjendje të bashkojnë shoqërinë, duke pasur parasysh sidomos rrezikun e copëzimit të audiencës, si rezultat i shumëllojshmërisë dhe veçantive të programeve që ofrohen.

21. Në lidhje me këtë, duke pasur parasysh larminë e platformave numerike, rregulli i detyrueshëm duhet të zbatohet për të mirën e transmetuesve publikë aq sa të jetë e

arsyeshme, me qëllim që të garantohet aksesimi në shërbimet dhe programet e tyre nëpërmjet këtyre platformave.

c. Financimi i transmetimit publik

22. Në kontekstin e ri teknologjik, pa një kuadër financimi të sigurtë dhe të përshtatshëm, mbulimi i transmetuesve publikë dhe shkalla e kontributit të tyre në shoqëri mund të zvogëlohet. Të përballura me rritjen e kostos së blerjes, prodhimit dhe ruajtjes së programeve, si dhe, ndonjëherë, kostot e transmetimit, shtete anëtare duhet t'i japin transmetuesve publikë mundësinë për të pasur mjetet e nevojshme financiare për të përmbushur detyrën e tyre.

Akti francez i Lirisë së Komunikimit Nr. 86-1067, datë 30.09.1986 (i ndryshuar)

Nenet 43-11

Shoqëritë e renditura në nenet 44 dhe 45 kryejnë shërbim publik në interes të publikut. Ato i ofrojnë publikut, në tërësi, një grup programesh dhe shërbimesh, që karakterizohen nga larmia dhe pluralizmi, kërkesa e tyre për cilësi dhe novacion, respektimi i të drejtave të njeriut dhe parimet demokratike të përcaktuara në kushtetutë.

Ato paraqesin një ofertë të larmishme programesh në mënyrë analoge dhe numerike në fushën e informacionit, kulturës, njohurive, argëtimit dhe sportit. Ato favorizojnë debatin demokratik, shkëmbimet midis pjesëve të ndryshme të popullsisë, si dhe integrimin në shoqëri dhe qytetari. Ato nxisin gjuhën frënge dhe nxjerrin në pah trashëgiminë kulturore dhe linguistike me larminë e saj rajonale dhe lokale. Ato kontribuojnë në zhvillimin dhe transmetimin e krijimtarisë intelektuale dhe artistike, si dhe të informacionit qytetar, ekonomik, social, shkencor dhe teknik, ashtu si dhe në edukimin audioviziv dhe median. Duke përdorur pajisje të përshtatura, ato favorizojnë aksesin në programet e tyre të transmetuara të personave që kanë probleme me dëgjimin.

Ato garantojnë integritetin, pavarësinë dhe pluralizmin e informacionit, si dhe shprehjen pluraliste të rrymave të mendimit dhe opinionit duke respektuar parimin e barazisë së trajtimit dhe rekomandimet e Këshillit të Lartë të Mjeteve Audiovizive. Institucionet e sektorit të komunikimit publik audioviziv, përsa i përket zbatimit të detyrës së tyre, kontribuojnë në veprimin e jashtëm audioviziv, në ndikimin e botës frëngjishtfolëse dhe transmetimin e gjuhës dhe kulturës frënge në gjithë botën. Ato përpiqen të zhvillojnë shërbime të reja, që mund të pasurojnë ose plotësojnë ofertën e programeve të tyre, si dhe teknologjitë e reja të prodhimit dhe transmetimit të programeve dhe shërbimeve të komunikimit audioviziv.

Një raport mbi zbatimin e dispozitave të këtij neni do të dorëzohet çdo vit në Kuvend.

Akti polak i Transmetimit i vitit 1992 (i ndryshuar)

Neni 21

1. Radiotelevizioni publik kryen misionin e tij publik duke i ofruar, sipas termave të përcaktuat në këtë Akt, gjithë shoqërisë dhe grupeve të saj individuale programe të larmishme dhe shërbime të tjera në fushën e informacionit, gazetarisë, kulturës, argëtimit, edukimit dhe sportit, të cilat duhet të jenë pluraliste, të paanshme, të ekuilibruara, të pavarura dhe të reja, të dalluara nga cilësia e lartë dhe integriteti i transmetimit.

1a. Detyrat e radiotelevizionit publik që dalin nga kryerja e misionit të tij të përcaktuar në paragrafin 1 do të përfshijnë në mënyrë të veçantë:

- 1) prodhimin dhe transmetimin e programeve kombëtare dhe rajonale, programeve për t'u ndjekur jashtë shtetit në gjuhën polake dhe në gjuhë të tjera, si dhe programeve të tjera që plotësojnë nevojat demokratike, sociale dhe kulturore të shoqërive vendase,
- 2) prodhimin dhe transmetimin e programeve tematike, në qoftë se është dhënë licencë për transmetimin e programeve të përmendura,
- 3) ndërtimin dhe funksionimin e transmetuesve radiotelevizivë dhe stacioneve të ritransmetimit,
- 4) transmetimin e shërbimeve të teletekstit,
- 5) punën për teknologjitë e reja të prodhimit dhe transmetimit të programeve radiotelevizive,
- 6) prodhimin, ofrimin e shërbimeve dhe zbatimin e veprimtarive tregtare që lidhen me prodhimin audioviziv, duke përfshirë eksportet dhe importet,
- 7) inkurajimin e veprimtarive artistike, letrare, shkencore dhe edukative,
- 8) përhapjen e njohurive për gjuhën polake,
- 9) prodhimin e programeve edukative dhe garantimin e aksesit në këto programe për njerëzit me origjinë polake dhe polakët që jetojnë jashtë,

2. Programet e radiotelevizionit publik duhet:

- 1) të udhëhiqen nga ndjenja e përgjegjësisë për përmbajtjen e mesazhit dhe nga nevoja për të mbrojtur emrin e mirë të radiotelevizionit publik,
- 2) të ofrojë informacion të besueshëm rreth larmisë së madhe të ngjarjeve dhe proceseve që zhvillohen në Poloni dhe jashtë saj,
- 3) të inkurajojnë një zhvillim të pakufizuar të pikëpamjeve të qytetarëve dhe formimin e opinionit publik,
- 4) të mundësojë qytetarët dhe organizatat e tyre të marrin pjesë në jetën publike duke shprehur pikëpamje dhe trajtime të ndryshme, si dhe duke ushtruar të drejtën e mbikqyrjes dhe kritikës sociale,
- 5) të ndihmojë në zhvillimin e kulturës, shkencës dhe arsimit, duke vënë një theks të veçantë mbi arritjet polake intelektuale dhe artistike,
- 6) të respektojë sistemin e krishterë të vlerave, duke u udhëhequr nga parimet universale të etikës,
- 7) t'i shërbejë forcimit të lidhjeve familjare,
- 7a) të çojë përpara zgjerimin e qëndrimeve pro shëndetit,
- 8) të kontribuojë në luftën kundër patologjive sociale,
- 9) të ketë parasysh nevojat e grupeve dhe pakicave etnike.